



GJEJE ZGJIDHJEN MË TË MIRË



E DREJTA E SHPREHJES SË LIRË

LEONORA (12), LIRIDON (13), EDI (12), ENIS (12), LAURA (12), QËNDRESA (12)



Çfarë është demokracia? Çfarë është media? Si lidhen këto dyja mes vete? Këto dhe më shumë Informata do të mund t'i lexoni më poshtë

Përshëndetje për ju lexues. Ne kemi përgatitur këtë artikull për t'iu njoftuar juve më shumë për demokracinë dhe për median. Biseduam për shumë gjëra. Bisedën tonë e filluam me shpjegimin e fjalës demokraci. Demokracia rrjedh nga gjuha greke, sepse ajo është shfaqur në Greqinë e lashtë. Fjalët e vjetra greke janë „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje. Pra, demokracia është udhëheqje e popullit. Kjo ka ndodhur në Athinë, në qytet-shtetin e Greqisë, në vitin 507 para erës sonë. Në atë kohë, popullsia e Athinës ka qenë e vogël dhe njerëzit që jetonin aty mbledheshin për të biseduar për çështje të rëndësishme për vendin e tyre. Mirëpo, në këto takime nuk kishin të drejtë për pjesëmarrje: gratë, të varfërit, jo vendasit apo të moshuarit. Me kohën, demokracia ka ndryshuar dhe sot ne kemi demokraci përfaqësuese. Në një shtet me demokraci qytetarët votojnë për përfaqësuesit e tyre. Për ta bërë këtë, ata duhet të mbushin 18 vjet.

Këto ishin faktet rreth demokracisë, kurse tani do të flasim për të drejtën e shprehjes së lirë dhe median. Ne jemi Liridoni dhe Leonora, dhe do t'iu flasim për median. Ne mësuam se media është formë përmes së cilës ne marrim informacione të sakta. Informacionet mund të jenë për gjëra që ndodhin brenda Kosovës, por edhe jashtë Kosovës. Kemi dy lloje të medias. Ato janë: media elektronike dhe media e shkruar. Në

media të shkruara hyjnë: revista, gazeta, libri, etj. Në media elektronike hyjnë: radio, televizori, telefoni, etj. Informacionet e transmetuara përmes medias, duhet të jenë: të sakta, të kontrolluara dhe të paanshme. Në qoftë se ne nuk e kemi një informacion të saktë, të kontrolluar, dhe nëse ne e shpërndajmë atë në rrjetet sociale mundemi ta ofendojmë dikë që e njohim, ashtu edhe dikë që nuk e njohim. Këshillë për juve: ju lutem mos postoni ose publikoni informacione të pasakta, sepse mund t'i lëndojmë njerëzit e tjerë. Tani dëshirojmë të ndajmë me juve një rast i cili ngjau pak kohë më parë. Mua më ka ndodhur diçka jo e këndshme. Një ditë e hapa Facebook-un tim të shikoja diçka. Aty pashë se dikush kishte shkruar një koment jo aq të mirë për mua. Unë kërkova nga ai person që ta largonte komentin, pasi që ai nuk ishte i vërtetë. Për fat të mirë, ai ishte person i kuptueshëm dhe e largoi atë koment menjëherë. Kjo pra është demokracia. Aty ku ne kemi të drejtë të shprehemi lirshëm.



Gazetarët e denjë të demokracisë

PËRGJEGJËSIA I TAKON POPULLIT

QËNDRIM (12), BENITA (12), AGNESA (12), ALBESA (12), ROLAND (12), BLERON (12), ANDUENA (13)



Ne do t'iu tregojmë se si ndërtohet shteti demokratik dhe çfarë vlere ka vota e secilit qytetar

Ne jemi nxënës të klasës së VII-të. Sot mësuam për demokracinë dhe zgjedhjet. Nëse iu intereson të dini pse kemi mësuar për këto koncepte, atëherë ne do t'iu tregojmë pikërisht arsyet.

Siç e dijmë të gjithë, demokracia na jep lirinë për të vendosur vetë për gjërat që ne i duam. Këtu përfshihet edhe e drejta jonë për të zgjedhur lirshëm. E çka nën-




Ti e ndërton shtetin tënd

kupton zgjedhja e lirë? Kjo nënkupton se ti si qytetar i Republikës së Kosovës, ke lirinë dhe mundësinë të vendosësh për të ardhmen tënde dhe të të shumë të tjerëve. E kjo realizohet me anë të fuqisë që ka vota. Fjala *votë* përbëhet nga 4 shkronja, me bashkimin e të cilave formohet koncepti më demokratik i vendit. Përmes saj, nuk ndikohet vetëm e ardhmja jote, por


edhe e shumë personave të tjerë të cilët punojnë dhe veprojnë në Kosovë. Votimi është proces ku të gjithë kanë mundësinë të trajtohen në mënyrë të barabartë. Përveç se ekziston liria për të votuar, qytetarët edhe vetë mund të kandidojnë që të jenë të zgjedhur. Por, jo të gjithë e dijnë rëndësinë e votës. Këtë e themi duke u bazuar në fshatin tonë, ku pjesëmarrja e qytetarëve në procesin zgjedhor nuk ishte aq sa duhej të ishte. Shumica e qytetarëve nuk votuan. Ne mendojmë se ata ka mundësi që nuk e dijnë saktësisht se shteti dhe e ardhmja e tyre përmirësohet vetëm nga një votë. Andaj, ne sot me njohuritë që i kemi marrë, do t'iu qasemi të gjithë bashkëqytetarëve të tjerë, dhe do t'iu tregojmë për vlerën dhe rëndësinë e votës. Ne do të mundohemi që edhe të tjerët të vetëdijësohen sa më shumë që të marrin vendime për veten e tyre. Nëse ndryshimi nuk fillon nga ne, si mund të presim që dikush tjetër të na sjell ndryshimin? Andaj, zgjohu edhe ti. Ti që mundesh dhe ke arsye për të ngritur zërin.



Grupi „Yjet demokratike“



Zemrat dhe kokat tona janë të mbushura me dashuri dhe mirëkuptim. Andaj, secili nga ne duhet të bëhemi vlerë e shtuar e shtetit tonë



Paqja dhe liria mbizotërojnë gjithmonë në shtetet demokratike



Jam shumë e kënaqur, sepse e di që të drejtat e mia mbrohen me ligj dhe me Kushtetutë



Bota është në duart tona. Nëse dijmë ta ruajmë edhe do të vazhdojmë ta kemi



Rruga e dijes është rruga më e mirë që duhet të ndjekim, sepse qytetarët e arsimuar japin shumë kontribute

KUVENDI I KOSOVËS

ERION (13), ENDRINA (12), ERIS (12), ENES (12), ELSA (12), RINESA (13), ARIOLA (12)



Funksionet e Kuvendit dhe rëndësia e tyre në jetën tonë si qytetarë

Ligji për automjete, ligji për fondet pensionale, ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, janë vetëm disa nga ligjet e miratuara në institucionin më demokratik, e që është Kuvendi i Kosovës. Pra, deputetët të cilët i zgjedhim ne me votën tonë, kanë për detyrë të mira-



tojnë ligje. Ky funksioni i Kuvendit njihet si funksioni legjislativ. Ju ndoshta e dini rëndësinë e ligjeve në jetën tonë, mirëpo, ne duam ta theksojmë prapë atë. Imagjinojeni se si do të ishte vendi ynë pa ligje. Një kaos i vërtetë. Prandaj, ne e kemi jetën të strukturuar dhe të rregulluar falë ligjeve. Kjo nënkupton se deputetët ndikojnë dhe janë të rëndësishëm në jetën tonë. Deputetët pos që miratojnë ligje kanë detyrë edhe të kontrollojnë Qeverinë. Ky funksion njihet si funksioni kontrollues. Ndërkaq, funksioni i tretë është ai

përfaqësues, sepse deputetët na përfaqësojnë neve. Në Kuvend janë 120 përfaqësues, 20 prej të cilëve u takojnë komuniteteve jo shumicë, të cilët jetojnë në vendin tonë. Gjithsesi, të gjithë deputetët janë të barabartë në të drejta dhe vendimmarrje, pa dallime. Si seanca plenare njihen mbledhjet e deputetëve, të cilat ne i ndjekim përmes televizorit.

Ne sot me shumë vëmendje i morëm të gjitha informatat për Kuvendin. Tani këto informata po i ndajmë me ju. Ah, ja edhe një shembull tjetër. Gjersa ne po shkruajmë tani, deputetët në Kuvend janë duke votuar për demarkacionin. Një çështje kjo e rëndësishme që na intereson të gjithë ne qytetarëve. Pra, Kuvendi ka ndikim të madh tek të gjithë ne. Për këtë arsye ne qytetarët duhet të zgjedhim me kujdes se kujt ia besojmë votën për të na përfaqësuar ne dhe vendin tonë. Faleminderit që e lexuat këtë artikull.



E duam Kuvendin dhe demokracinë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Halit Ibishi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Cërnill, Ferizaj